



Nr. 23200 prot.

Tiranë, më 12.07.2023

LËNDA: Rregullorja bazë për zhvillimin e Kampionatit Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në “Telegrafi – Shpejtësi e Lartë”.

PËRMBAJTJA

- A - HYRJE
- B - ORGANIZIMI
- C - PROGRAMI I KAMPIONATIT
- D - TEKNIKA
- E - KLASIFIKIMET DHE VLERËSIMET
- F - ÇËSHTJE QË NUK MBULOHEN NGA KËTO RREGULLA

A - HYRJE

A1 Rregullat e mëposhtme janë bazuar plotësisht në Rregulloren e IARU për Kampionatin Botëror të HST dhe do të përdoren për organizimin dhe mbajtjen e Kampionatit Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në “Telegrafi – Shpejtësi e Lartë” në Shqipëri.

A2 Për të siguruar konsistencë në standardet e aplikuara në garat HST, duhet që këto rregulla, të përshtatura, të përdoren gjithashtu për Kampionatet Rajonale ose Krahinore të HST të organizuara dhe mbajtura nga Shoqatat apo Klubet Sportive të Radioamatorizmit anëtare të FSHR-së në rrethe.

B – ORGANIZIMI

B1 Parathënie

B1.1 Shoqata ose klubi sportiv radioamator që ka fituar herën e fundit Kupa e Shqipërisë në “Telegrafi – Shpejtësi e Lartë”, ka të drejtë të marrë përsipër rolin “Shoqëri Organizuese” për Kampionatin Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në “Telegrafi – Shpejtësi e Lartë”. Në mungesë të interesi apo mundësie për organizimin, Grupi i Punës për Garat “Telegrafi Shpejtësi e Lartë” do të dërgojë një letër të gjitha shoqërive e klubeve anëtare me anë të cilës do të pyesë nëse ata janë të gatshëm të marrin përsipër rolin “Shoqëri Organizuese për Kampionatin Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në “Telegrafi – Shpejtësi e Lartë””. Çdo letër do të kërkojë një përgjigje brenda DY MUAJSH nga data e marrjes së saj. Nëse nuk merret asnjë përgjigje brenda kësaj periudhe, përgjigja supozohet të jetë negative dhe grupi i punës merr vendim se ku do të mbahen aktivitetet sportive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

B1.2 Pas marrjes së një përgjigjeje pozitive nga një ose më shumë shoqëri, Grupi i Punës HST do të emërojë një Shoqëri apo Klub sportiv Radioamator për të organizuar Kampionatin Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në “Telegrafi – Shpejtësi e Lartë” (më tej i referuar si Shoqëria Organizuese). Një vendim i tillë mund do të merret me votim gjatë mbledhjes së KE, me votim postar ose me votim nëpërmjet e-mail. Vendimi i marrë do të njoftohet sa me parë në faqen e internetit të FSHR-së, si dhe në faqet e internetit të Shoqatave e Klube Sportive Radioamatore, në Facebook, etj..

B1.3 Kampionati i radhës zhvillohet vitin që pason periudhën përgatitore paraprake.

B2 Pjesëmarrja, Financat dhe Organizimi

B2.1 Një ekip që merr pjesë në Kampionatin Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në “Telegrafi – Shpejtësi e Lartë” mund të përbëhet nga çdo numër deri në maksimumi 27 (njëzet e shtatë) KONKURRENTË në 9 (nëntë) kategoritë e mëposhtme. Pra ekipet do të përbëhen nga:

“**Kategoria A - PARA TË RINJ - FEMRA**” Jo më shumë se TRE “PARA TË RINJ - FEMRA” (konkurrentët i përkasin kësaj kategorie deri në fund të vitit kalendarik në të cilin ata arrijnë moshën 16 vjeç);

“**Kategoria B - PARA TË RINJ - MESHKUJ**” Jo më shumë se TRE “PARA TË RINJ - MESHKUJ” (konkurrentët i përkasin kësaj kategorie deri në fund të vitit kalendarik në të cilin ata arrijnë moshën 16 vjeç);

“**Kategoria C - TË RINJ - FEMRA**” Jo më shumë se TRE “TË RINJ - FEMRA” (Konkurrentët i përkasin kësaj kategorie deri në fund të vitit kalendarik në të cilin ata arrijnë moshën 21 vjeç);

“**Kategoria D - TË RINJ - MESHKUJ**” Jo më shumë se TRE “TË RINJ - MESHKUJ” (Konkurrentët i përkasin kësaj kategorie deri në fund të vitit kalendarik në të cilin ata arrijnë moshën 21 vjeç);

“**Kategoria E - FEMRA**” Jo më shumë se TRE “FEMRA” (Konkurrentët mund të konkurrojnë në këtë kategori pavarësisht nga mosha e tyre).

“**Kategoria F - MESHKUJ**” Jo më shumë se TRE “MESHKUJ” (Konkurrentët mund të konkurrojnë në këtë kategori pavarësisht nga mosha e tyre);

“**Kategoria G - SENIOR - FEMRA**” Jo më shumë se TRE “SENIOR - FEMRA” (Konkurrentët mbi 40 vjeç i përkasin kësaj kategorie që nga fillimi i vitit kalendarik në të cilin ata arrijnë moshën e caktuar);

“**Kategoria H - SENIOR - MESHKUJ**” Jo më shumë se TRE “SENIOR - MESHKUJ” (Konkurrentët mbi 40 vjeç i përkasin kësaj kategorie deri në fund të vitit kalendarik në të cilin ata arrijnë moshën 49 vjeç);

“**Kategoria I - SENIOR - MESHKUJ**” Jo më shumë se TRE “SENIOR - MESHKUJ” (Konkurrentët mbi 50 vjeç i përkasin kësaj kategorie që nga fillimi i vitit kalendarik në të cilin ata arrijnë moshën e caktuar);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

Çdo ekip duhet të ketë një UDHËHEQËS EKIPI të emëruar, i cili duhet të jetë të paktën 18 vjeç. Një konkurrent mund të veprojë edhe si udhëheqës ekipi. Një trajner, arbitra, si dhe një numër i pacaktuar vizitorësh mund të shoqërojnë gjithashtu çdo ekip.

B2.1.1 Konkurrentët duhet të jenë qytetarë të rrethit apo qytetit ku shoqëria apo klubi sportiv ka selinë dhe të jenë anëtarë të saj të federuar . Të huaj të tjerë që jetojnë të paktën një vit në qytetin/rrethin në fjalë mund të marrin pjesë edhe për shoqërinë ose klubin sportiv të këtij vendi nqs janë anëtarësuar dhe janë federuar paraprakisht; ligjshmëria e vendbanimit duhet të provohet me një dokument zyrtar. Çdo përjashtim nga kjo kërkon miratimin e KE dhe shoqërive e klubeve sportive që marrin pjesë në gara.

B2.2 Të gjithë konkurrentët duhet të jenë radioamatorë të licencuar, përjashtime lejohen për kategoritë **A, B, C** dhe **D** të cilët mund të jenë SWL të licencuar ose anëtarë të regjistruar dhe të federuar të shoqërive e klubeve sportive të tyre. Dokumenti identifikues personal që tregon datën e lindjes së konkurrentëve duhet të dorëzohet FSHR-së NJË MUAJ përpara Kampionatit dhe më së voni në momentin e mbërritjes në vendin e garës.

B2.3 Për qëllime trajnimi dhe promovimi, Shoqëria Organizuese mund të ftojë një ekip shtesë. Ky ekip mund të marrë pjesë jo-zyrtarisht në Kampionat, por as konkurrentët dhe as ekipi nuk do të listohen në rezultatet zyrtare.

B2.4 Shoqëria Organizuese do të dërgojë ftesa për të marrë pjesë në Kampionat për shoqëritë dhe klubet e tjera anëtare të FSHR-së dhe sekretariatit të FSHR-së për informacion. Këto ftesa duhet të dërgohen jo më vonë se TRE MUAJ para fillimit të Kampionatit. Ftesat duhet të informojnë Shoqëritë tjera se nëse ato nuk kanë vendosur që të dërgojnë një ekip përfaqësues në Kampionat, atëherë ato mund të ftojnë individë të marrin pjesë në Kampionat (maksimumi 2 persona/kategori).

B2.4.1 Në rastin e veprimtarive ku edhe të rinjtë (nën 18 vjeç) do të jenë konkurrentë, FSHR merr përsipër zbatimin e plotë të Politikave së Mbrojtjes së Fëmijëve të IARU-t dhe ITU-së. Këto politika janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit!

Organizatorët e aktivitetit dhe vullnetarët organizatorë duhet të lexojnë dhe të kuptojnë Principet e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të nënshkruajnë për të konfirmuar se do të veprojnë sipas kërkesave të përcaktuara aty.

Funksionarët e ekipit duhet të lexojnë dhe të kuptojnë Principet e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të nënshkruajnë për të konfirmuar se bien dakord të respektojnë kërkesat e përcaktuara aty.

Anëtarët e Jurisë duhet të lexojnë dhe të kuptojnë Principet e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të nënshkruajnë për të konfirmuar se bien dakord të respektojnë kërkesat e përcaktuara aty.

Nëse dikush nuk është i gatshëm të nënshkruajnë deklaratën, atëherë nuk do të lejohet të marrë pjesë në aktivitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

B2.5 Shoqëritë që kanë vendosur të dërgojnë një ekip ose individë për pjesëmarrjen në Kampionat, duhet të dërgojnë një letër tek Shoqëria Organizuese jo më vonë se DY MUAJ para fillimit të Kampionatit. Kjo letër duhet të tregojë numrin e pjesëmarrësve (deri në 27 konkurrentë) dhe të tjerë që do të marrin pjesë në aktivitet (udhëheqës ekipi, trajner, vizitorë etj.) Asnjë informacion tjetër nuk kërkohet në këtë kohë.

B2.5.1 Shoqëritë anëtare të FSHR që marrin pjesë në kampionatin HST për herë të PARË do të lejohen të përdorin tastierat e tyre dhe standardin kombëtar të tastierës. FSHR është e detyruar të informojë kryetarin e grupit të punës dhe Shoqërinë Organizuese JO më vonë se 2 (dy) muaj para kampionatit nëse dëshirojnë të përdorin këtë opsion.

B2.6 Shoqëria Organizuese duhet të dërgojë SHOQËRIVE PJESEMARRËSE, jo më vonë se DY MUAJ para fillimit të Kampionatit:

- a) Programin e plotë të Kampionatit, duke përfshirë oraret dhe vendndodhjen e të gjitha ngjarjeve;
- b) Informacion mbi mundësitë e udhëtimit lokal, për shembull, se si të arrini në hotel(et) nga aeroporti më i afërt, stacioni hekurudhor, stacioni autobusëve, etj.;
- c) Informacion i përgjithshëm mbi hotelet (akomodim dhe bord) pranë Kampionatit, me të paktën një shembull specifik, duke përfshirë kostot;
- d) Detajet e llojeve të kufjeve dhe llojit të saktë të fisheve të dispozicion për të lidhur tastierën e konkurrentëve;
- e) Çdo informacion tjetër i rëndësishëm që konsiderohet i nevojshëm;
- f) Formularët zyrtarë të aplikimit për t'u plotësuar nga Shoqëritë Pjesëmarrëse. Këto formularë duhet të përmbajnë të gjitha informacionet përkatëse përveç emrave të pjesëmarrësve dhe duhet të kthehen në Shoqërinë Organizuese jo më vonë se NJË MUAJ para fillimit të Kampionatit. Ftesat duhet t'u dërgohen REFERENTËVE të përzgjedhur siç përcaktohet në Rregullën **B3.2** për të shërbyer në Jurinë Kombëtare për Kampionatin HST.

B2.7 Shoqëritë pjesëmarrëse duhet të paraqesin emrat e të gjithë pjesëmarrësve, me thirrjet e tyre ose Numrat SWL, në Sekretariatit e Kampionatit në formë të shkruar (d.m.th., me letër, faks ose mjete të tjera), jo më vonë se NJËZET E KATËRT ORË para mbledhjes së parë të Jurisë Kombëtare në Kampionat.

B2.8 Shoqëritë pjesëmarrëse duhet të mbulojnë shpenzimet e ekipeve të tyre, përfshirë vizitorët/shoqëruesit që marrin pjesë në Kampionat si më poshtë: kostoja e udhëtimit nga dhe drejt vendit të Kampionatit dhe kostoja e akomodimit dhe bordit gjatë periudhës së Kampionatit.

B2.9 Shoqëria Organizuese duhet të mbulojë shpenzimet Administrative dhe Teknike që rrjedhin nga Kampionati.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

B2.10 Kostoja e akomodimit dhe bordi i plotë i Kryetarit dhe të gjithë anëtarëve të Jurisë Kombëtare (referuesit për transmetim, Morse Runner, RUFZ dhe referuesi teknik për marrje) do të mbulohet nga Shoqëria Organizuese.

B2.11 Sipas ligjit për Sportin në Shqipëri, duhet që Kampionati Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në HST të zhvillohen një herë në vit.

B2.12 Që të lejohen të fillojnë si konkurrentë zyrtarë në një kampionat kombëtar HST të FSHR-së, Shoqëritë Anëtare të FSHR-së duhet të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre financiare ndaj FSHR-së deri në fund të muajit përpara muajit në të cilin zhvillohet Kampionati. Nëse kërkohet, do të sigurohen mundësitë për të pranuar tarifën e papaguara së bashku me pagesën e tarifës dhe shpenzimeve të kampionatit.

Shoqëria organizuese mund të lejojë Shoqëritë Anëtare të pafederuara me tarifa të papaguara ndaj FSHR-së të marrin pjesë në Kampionate jashtë konkurrencës d.m.th. të mos renditen dhe të mos u jepen medalje.

Komiteti Ekzekutiv i FSHR-së mund të lejojë Shoqatat e Radioamatorëve në qytete apo rrethe, të cilat nuk janë anëtare të FSHR, të marrin pjesë zyrtarisht si konkurrentë të plotë në kampionate kombëtare HST. Një leje e tillë normalisht do të jepet vetëm për një vit si një hyrje në këtë aktivitet.

B2.13 Çdo konkurrent nga kategoria **A**, **C** dhe **G** mund të konkurrojë në kategorinë **E** dhe çdo konkurrent nga kategoria **B**, **D**, **H** dhe **I** mund të konkurrojë në kategorinë **F**.

Gjithashtu, çdo konkurrent nga kategoria **A** mund të konkurrojë në kategorinë **C**, çdo konkurrent nga kategoria **B** mund të konkurrojë në kategorinë **D** dhe çdo konkurrent nga kategoria **I** mund të konkurrojë në kategorinë **H**.

Për një konkurrent fitues për t'u kualifikuar në një kategori ose garë si Kampion Kombëtar, duhet që të ketë të paktën tre konkurrentë që marrin pjesë në të njëjtën kategori. Konkurrentët në kategorinë **TË RINJ - FEMRA (C)** dhe **TË RINJ - MESHKUJ (D)**, dhe **SENIOR - FEMRA (G)**, **SENIOR - MESHKUJ (H)** duhet të konkurrojnë në kategoritë **FEMRA (E)** dhe **MESHKUJ (F)** përkatësisht nëse ka më pak se tre konkurrentë pjesëmarrës në kategorinë e tyre.

Konkurrentët në kategoritë **PARA TË RINJ - FEMRA (A)** dhe **PARA TË RINJ - MESHKUJ (B)** duhet të konkurrojnë në një kategori më të lartë, të zgjedhur midis kategorive **TË RINJ - FEMRA (C)** dhe **TË RINJ - MESHKUJ (D)** ose **FEMRA (E)** dhe **MESHKUJ (F)** dhe konkurrentët në kategorinë **SENIOR - MESHKUJ (I)** duhet të konkurrojnë në një kategori më të lartë të zgjedhur midis kategorive **SENIOR - MESHKUJ (H)** ose **MESHKUJ (F)** nëse ka më pak se tre konkurrentë pjesëmarrës në kategorinë e tyre.

Megjithatë, për numërimin e rezultateve të ekipit, rezultatet e këtyre konkurrentëve do të zhvendosen në kategoritë e tyre origjinale, d.m.th. **PARA TË RINJ, TË RINJ** ose **SENIOR**.

B2.14 Kryetari i Grupit të Punës do të vizitojë Shoqërinë Organizuese për të koordinuar përgatitjet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

B3 Juria Kombëtare

B3.1 Juria Kombëtare për Kampionatin HST të FSHR do të përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Kryetari i Jurisë;
- b) Sekretari i Jurisë;
- c) Referenti Teknik;
- d) Referentët Kombëtarë të HST (Juri Senior) dhe Anëtarë të tjerë të Jurisë

Kur numri i konkurrentëve në kampionat është me i vogël se 30, atëherë për të zvogëluar shpenzimet lejohet që Juria Kombëtare të përbëhet nga më pak anëtarë ose vetëm nga NJË anëtar person me integritet dhe i paanshëm për të gjitha shoqëritë apo klubet pjesëmarrëse.

B3.2 Kryetari i Grupit të Punës HST është Kryetar i Jurisë. Në mungesë të tij, nënkryetari i Grupit të Punës ose Referenti Kombëtar i emëruar nga Komiteti Ekzekutiv mund të marrë përgjegjësinë e Kryetarit të Jurisë. Të gjithë referentët (maksimumi 4 për transmetim, 4 për Morse runner dhe RUFZ dhe referenti teknik për marrje) do të zgjidhen nga Grupi i Punës katër muaj para fillimit të Kampionatit. Referentët për transmetim do të formojnë dy grupe të Jurisë Transmetuese. Të gjithë anëtarët e Jurisë do të zgjidhen siç përshkruhet në **Shtojcën J**, nga përfaqësuesit e disa shoqatave dhe klubeve. Ata do të merren nga sa më shumë Shoqëri apo Klube sportive të jetë e mundur. Emrat e anëtarëve të Jurisë Kombëtare do të shpallen para fillimit të Kampionatit.

B3.3 Referentët Kombëtarë që janë anëtarë jo-konkurrentë të ekipeve (dhe nuk janë emëruar më parë nga Grupi i Punës) mund të ftohen të shërbejnë si anëtarë të plotë të Jurisë Kombëtare. Udhëheqësit e ekipeve dhe trajnerët që nuk janë anëtarë të Jurisë Kombëtare mund të marrin pjesë në mbledhjet e Jurisë, por nuk do të kenë të drejtë vote.

B3.4 Juria Kombëtare do të mbledhet ditën para fillimit të Kampionatit për të miratuar orarin përfundimtar dhe detajet teknike të Kampionatit.

B3.5 Në fund të çdo dite të Kampionatit, Juria Kombëtare do të mbledhet për të diskutuar dhe miratuar rezultatet e asaj dite. Juria duhet të lejojë të paktën NJË orë kohë pas postimit të rezultateve paraprake më të fundit, para fillimit të mbledhjes. Kryetari i Jurisë, në varësi të rrethanave (sidomos orari), mund të shtyjë mbledhjen ose miratimin e rezultateve të një gare/kategorie për mëngjesin tjetër, sipas gjykimit të tij.

B3.5.1 Sekretari do të postojë rezultatet paraprake për çdo garë/kategori në vendin/vendet zyrtarisht të miratuar sapo ato të jenë përgatitur. Këto rezultate duhet të shënohen qartë PARAPRAKE ose JOZYRTAR, së bashku me KOHËN E SAKTË që janë postuar. Udhëheqësit e ekipeve mund të depozitojnë protesta, nëse ka, tek Kryetari i Jurisë brenda NJË ORE pas postimit.

B3.5.2 Pas miratimit të Jurisë, Sekretari do të zëvendësojë rezultatet paraprake me një tjetër grup, të shënuar qartë FINAL ose ZYRTAR, ose të njëjtat lista mund të nënshkruhen nga Kryetari i Jurisë dhe të shënohen FINAL ose ZYRTAR.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

B3.6 Në rastet e mosmarrëveshjes, të cilat nuk mund të zgjidhen duke iu referuar Rregullave, Juria do të marrë një vendim me anë të votimit. Në rast barazimi, Kryetari i Jurisë do të ketë një votë përcaktuese.

B3.7 Vendimet e Jurisë Kombëtare janë përfundimtare dhe nuk mund të apeloohen por në raste të veçanta ato mund të rishikohen.

B3.8 Gjatë të gjitha ngjarjeve të Kampionatit, të gjithë anëtarët e Jurisë duhet të veshin emblema të dukshme të shënuara me "JURI".

C - PROGRAMI I KAMPIONATIT

C1 Kampionati Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë në HST do të përbëhet nga garat si më poshtë:

a) **MARRJE** e grupeve të formuara nga 5 (pesë):

- 1) Shkronja
- 2) Numra
- 3) të përziera

për një periudhë prej NJË minute sipas programeve (**Shiko Shtojca A1**).

b) **TRANSMETIMI** i grupeve të formuara nga 5 (pesë):

- 1) Shkronja
- 2) Numra
- 3) të përziera

për një periudhë prej NJË MINUTE

c) Garat e Praktikës së Radioamatorit (**Shiko shtojcën A1**)

- 1) **Gara e Marrjes së Shenjave të Thirrjeve të Radioamatorëve** me RUFZ-XP
- 2) **Gara e Simulimit të Contest** me Morse Runner

D - TEKNIKAT

D1 Rregullat për Garat e Konkurrimit

D1.1 Konkurrentët mund të kenë:

- vetëm një përpjekje në çdo shpejtësi (Shkronjë, Numër, Të përzier) në Garën MARRJE
- një përpjekje (Shkronjë, Numër, Të Përzier) dhe vetëm një shtesë (Shih D2.2.8) në Garën TRANSMETIM,
- dy përpjekje në garën e marrjes së shenjave të thirrjes së Radioamatorit **RufzXP**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

- dy përpjekje në garën e simulimit të contest me **Morse Runner**. Në raste të veçanta, mund të lejohet një përpjekje shtesë në rastin e:

- a) Probleme të furnizimit me energji elektrike
- b) Funkzionim i keq i pajisjes së siguruar nga Shoqëria Organizatore.

Shënim: Ky rregull nuk zbatohet për funksionimin e keq të ndonjë pajisjeje të konkurrentëve, d.m.th. kufjet e tyre, çelësin transmetues, kabllo të lidhur, laptop ose ndonjë pajisje tjetër të mundshme të tyre. Në rast të një funksionimi të tillë e me probleme, konkurrentëve NUK DO T'U LEJOHET një përpjekje shtesë.

D2.1 GARA E MARRJES

D2.1.1 Konkurrentët mund të regjistrojnë tekstet e marra me dorë në letër ose duke përdorur një laptop. Tekstet me shkronja do të formohen nga 26 shkronjat latine. Grupet e numrave do të formohen nga 10 numrat arabikë. Grupet e tekstit të përzier, përveç shkronjave dhe numrave të mësipërm, do të përfshijnë shenjat e mëposhtme të pikësimi: ., ? / =

Karakteret identike njëra pas tjetrës nuk do të dërgohen më shumë se dy herë brenda një grupi, për shembull: SSGHH, 78831, .??=?

D2.1.2 Tekstet do të transmetohen me shpejtësi në rritje. Shpejtësia do të rritet në intervale prej DHJETË shenjash në minutë.

D2.1.3 Frekuenca e sinjalit audio duhet të jetë brenda gamës 700-2000 Hz. Kufjet me kontrollues të volumit duhet të sigurohen për konkurrentët nga Shoqëria Organizuese. Konkurrentëve NUK U LEJOHET të përdorin kufjet e tyre.

D2.1.4 Gjatë garave të marrjes, çdo konkurrent mund të marrë deri në 10 shpejtësi të ndryshme në çdo garë (shkronja, numra, të përziera), pra një konkurrent mund të zgjedhë nga 1 deri në maksimumi 10 shpejtësitë që ai/ajo dëshiron të marrë.

Shpejtësia më e ulët përcaktohet në Shtojcën A3. Nuk ka nevojë që shpejtësitë e zgjedhura të jenë me radhë.

Shembull: 150, 170, 180, 200, 210, 230

D2.1.5 Nënndarja e konkurrentëve në disa grupe sipas niveleve të tyre të aftësive të njohura (ose rrethana të tjera) mund të lejohet me qëllim vendosjen e tyre në dhoma të ndara. Konkurrentëve u lejohet të përdorin laptop-in e tyre me ose pa tastierë të jashtme për marrjen, por nuk lejohen të përdoren makinat e shtypit.

D2.1.6 Gara do të fillojë me marrjen e grupeve të shkronjave, të ndjekur nga grupet e numrave dhe pastaj grupet e tekstit të përzier.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

D2.1.7 Konkurrentët mund të përdorin çdo simbol (stenografi, etj.), të shkruar me dorë, për të regjistruar sinjalet e marra dhe mund të përdorin letrën e tyre për këtë qëllim. Kur gara të përfundojë, mesazhet e marra duhet të rishikohen në një kompjuter zyrtar të siguar nga referenti. Fletët e letrës origjinale të përdorura për marrjen e mesazheve duhet të dorëzohen tek referenti pas procedurës së rishikimit. Pas garës, konkurrentët mund të marrin përsëri letrat e tyre origjinale.

D2.1.8 Kur mesazhet e marra janë shkruar me dorë, një periudhë prej TRITËDHJETË MINUTASH do të lejohet pas çdo gare që konkurrentët të rishikojnë TRE MESAZHE TË ZGJEDHURA të marra në atë garë. Teksti duhet të rishikohet në përputhje me programin e garës së marrjes. (**shiko Shtojcën A2**). VETËM NJË MESAZH, duke dhënë rezultatin më të mirë, do të numërohet për garën.

D2.1.9 Konkurrentët që marrin me laptop duhet të ndjekin të njëjtat rregulla të rishikimit, pavarësisht nëse shkruajnë me dorë apo i shtypin mesazhet e tyre zyrtare.

D2.1.10 Mesazhet e dërguara në një garë marrjeje me një shpejtësi të caktuar duhet të kenë sinjalet procedurale të mëposhtme (**Shiko shtojcën C**)

D2.1.11 Një mesazh praktikë ose njohjeje do të dërgohet vetëm NJË HERË, para se të dërgohet mesazhi i parë i garës.

D2.1.12 Mesazhet e marra do të vlerësohen vetëm nëse numri i gabimeve nuk tejkalon PESË (**Shiko shtojcën D**)

D2.1.13 Vlerësimi do të jetë si më poshtë: Për secilin nga Garat e Marrjes (Shkronja, Numra dhe Teksti i Përzier), një rezultat prej 100 pikësh do t'i jepet konkurrentëve që marrin mesazhin (të klasifikuar) të dërguar me shpejtësinë më të lartë në kategorinë e tij/saj. Konkurrentët në të njëjtën kategori që marrin mesazhin me një shpejtësi më të ulët do të vlerësohen proporcionalisht siç shpjegohet në shembullin vijues.

SHEMBULL:

100 pikë i jepen konkurrentëve që morën shpejtësinë më të lartë në një garë marrjeje. Shpejtësia më e lartë është: shpejtësia e transmetuar minus numri i gabimeve. Nëse një konkurrent mori shpejtësinë prej 260 shenjash në minutë me 3 gabime, shpejtësia më e lartë do të jetë $260 - 3 = 257$.

Nëse një konkurrent tjetër në të njëjtën kategori merr një mesazh me një shpejtësi prej 210 shenjash në minutë me 2 gabime, rezultati i tij/saj do të jetë $(210 - 2) / 257 \times 100 = 80.9$ pikë, i llogaritur deri në një të dhjetën e një pike.

D2.2 GARAT E TRANSMETIMIT

D2.2.1 Shoqëria organizuese duhet të sigurojë dhomat dhe pajisjet për transmetim me kufje cilësore në mënyrë që konkurrentët të mund të monitorojnë transmetimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

D2.2.2 Konkurrentët mund të përdorin tasto vertikale/të drejtë ose elektronike (paddle të vetme ose të dyfishtë) për garat e transmetimit. Nëse dëshirojnë, ata mund të përdorin një tasto të drejtë për një ose më shumë nga tre garat dhe një tasto elektronike për pjesën tjetër. Tastot elektronike duhet të kenë patjetër një raport pikë-vizë 1:3.

D2.2.3 Mesazhet për transmetim do të përbëhen nga 60 grupe me 5 karaktere për çdo garë (d.m.th., grupe shkronjash, grupe numrash dhe grupe teksti të përzier).

D2.2.4 Teksti i një mesazhi të dhënë konkurrentëve për transmetim do të printohet me shkronja latine të mëdha dhe/ose numra arabikë. Do të ketë pesë grupe në një rresht. Çdo tekst transmetimi duhet të jetë i lexueshëm mirë dhe karakteret “zero” duhet të shkruhen me slash (Ø) në tekstin e përzier (**Shiko shtojcën E**).

D2.2.5 Tre mesazhe TRAJNIMI (një përbërës nga grupet e shkronjave, një grup numrash dhe një tekst i përzier) do t’u jepen të gjithë konkurrentëve në ditën e arritjes në garë. Tre mesazhe GARIMI do të prodhohen nga kompjuteri në prani të Anëtarëve të Jurisë nga të paktën 3 shoqëri ose klube të ndryshme. Të njëjtat mesazhe do t’u jepen të gjithë konkurrentëve brenda të njëjtit grup. Pamja vizuale e mesazheve të garës DUHET të jetë e njëjtë me mesazhet e trajnimit (madhësia e shenjave, hapësira, trashësia shkronjave, etj.). Konkurrentët do të shohin mesazhet e garës vetëm pasi të hyjnë në dhomën e garës.

D2.2.6 Konkurrentëve u lejohe të qëndrojnë DYMBËDHJETË MINUTA në dhomën e transmetimit për të dërguar tre mesazhet e dhëna. Kjo periudhë fillon në momentin që konkurrentët hyjnë në dhomën e garimit. Periudha e transmetimit për çdo garë do të jetë NJË MINUTË duke filluar me një sinjal nga referenti. Nëse një konkurrent i thirrur nga referenti nuk paraqitet në dhomën e garimit për arsye të arsyeshme (problem shëndetësor, etj.), ai/ajo do të thirret përsëri pas NJË MINUTE, dhe pas një periudhe tjetër prej NJË MINUTE referenti do të thërrasë konkurrentin tjetër në listë. Konkurrentët, të cilët nuk arriten të shfaqen brenda radhës së tyre, automatikisht do të zhvendosen në fund të listës së radhës dhe koha në dispozicion për përpjekjen e tyre do të reduktohet në 8 minuta. Në rast se i njëjti konkurrent nuk arrin përsëri të shfaqet brenda radhës së tij të re, ai/ajo do të diskualifikohet dhe nuk do t’i jepet ASNJË PIKË për Garat e Transmetimit. Vetëm anëtarët e jurisë kanë të drejtë të përcaktojnë nëse ka një arsye të justifikueshme për mungesën e konkurrentëve.

D2.2.7 Pasi një konkurrent të ketë lidhur taston e tij/saj me pajisjen e garimit, nuk lejohe ndihmë e mëtejshme dhe trajneri duhet të largohet nga dhoma e transmetimit (nëse ka qenë atje).

D2.2.8 Pas dërgimit të TRE mesazheve nga një konkurrent, ai/ajo ka të drejtë të ri-transmetojë një nga mesazhet nëse ka ende kohë të mjaftueshme për të përfunduar një përpjekje shtesë. Në këtë rast, pasi përpjekja shtesë të përfundojë, një konkurrent u thotë referentëve cilën përpjekje të konsiderojnë zyrtare dhe nënshkruajnë dokumentin përkatës. Teksti i transmetuar duhet të kontrollohet në përputhje me programin për këto gara (**shiko Shtojcën A2**).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

D2.2.9 Para transmetimit të një mesazhi në garën e transmetimit, një konkurrent duhet të transmetojë VVV dhe = SHEMBULL: VVV = TEKSTI I MESAZHIT

Koha e mesazhit do të fillojë pas transmetimit të sinjalit të ndërprerjes (=). Pas NJË MINUTE, referenti teknik do të ndërpresë transmetimin. Juria kontrollon mesazhet e transmetimit të një konkurrenti nga seria VVV dhe sinjali i ndërprerjes (=).

D2.2.10 Mesazhet e transmetuara do të vlerësohen deri në një minutë ose deri në kohën kur numri i gabimeve të pa korrigjuara tejkalon TRE (**shiko Shtojcën F**).

D2.2.11 Gjatë garave të transmetimit, rekomandohet që referentët dhe konkurrentët të vendosen në dhoma të ndara ose të paktën të ndahen nga një perde. Referenti teknik, i cili mbikëqyr dhe/ose ndihmon konkurrentët të lidhin fishat e tastove të tyre me pajisjen e transmetimit dhe kontrollon kohëzgjatjen e çdo gare, duhet të qëndrojë në dhomë me konkurrentët. Të gjitha tekstet e transmetuara do të regjistrohen për qëllime kontrolli. Konkurrentët që i përkasin të njëjtës kategori duhet të transmetojnë me të njëjtën juri. Rekomandohet që gjatë transmetimit, konkurrimi të mund të monitorohet edhe jashtë në mënyrë që edhe publiku të mund të ndjekë ngjarjen. Por publiku nuk duhet në asnjë mënyrë të shikojë tekstin e garës në ekran ose ta dëgjojë atë në altoparlantë.

D2.2.12 Një Juri prej tre REFERENTËSH KOMBËTARË do të përcaktojë veçmas numrin e shenjave të transmetuara, numrin e gabimeve dhe koeficientin për cilësinë e dhënies. Koeficienti i përgjithshëm i dhënë do të jetë mesatarja aritmetike e koeficienteve të dhënë nga secili referent. Referenti që regjistron rezultatin do të emërohet si udhëheqës i referentëve.

D2.2.13 Vlerësimi do të jetë si më poshtë: Në secilin nga Garat e Transmetimit (Shkronja, Numra dhe Teksti i Përzier), një rezultat prej 100 pikësh do t'i jepet konkurrentëve që transmetojnë mesazhin me shpejtësinë më të lartë në kategorinë e tij/saj. Konkurrentët në të njëjtën kategori që transmetojnë mesazhin me një shpejtësi më të ulët do të vlerësohen proporcionalisht siç shpjegohet në shembullin vijues.

SHEMBULL: Nëse shpejtësia më e lartë në një garë transmetimi është 230 shenja në minutë, jepen 100 pikë. Nëse një konkurrent tjetër në kategori transmeton një mesazh me një shpejtësi prej 180 shenjash në minutë, rezultati i tij/saj do të jetë $180 \div 230 \times 100 = 78.3$ pikë, i llogaritur në një të dhjetën më të afërt të një pike.

Rezultati i llogaritur do të modifikohet më pas nga shumëzimi me një koeficient zvogëlues bazuar në numrin e gabimeve të pa korrigjuara dhe dhënie jo-uniforme (cilësia) siç përcaktohet në **Shtojcën G**.

SHEMBULL: Një gabim i pa korrigjuar ka koeficient 0.05 dhe dhënia jo-uniforme merr koeficient 0.02 atëherë rezultati përfundimtar është $78.3 \times (1 - (0.05 + 0.02)) = 78.3 \times 0.93 = 72.81 = 72.8$ pikë.

Kur shifra e dytë pas pikës dhjetore është 1,2,3 ose 4, atëherë numri i parë pas pikës dhjetore duhet të rrumbullakohet poshtë përndryshe për 5,6,7,8 ose 9 ai rrumbullakohet lart. p.sh. rezultati me 8.74 do të bëhet 8.7 dhe 8.75 do të bëhet 8.8.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

D2.3 GARAT E PRAKTIKËS

D2.3.1 GARA E MARRJES SË SHENJAVE TË THIRRJEVE TË RADIOAMATORËVE (RUFZ-XP)

Kjo garë zhvillohet në kompjutera IBM-kompatibël në prani të dy Anëtarëve të Jurisë që janë nga vende të ndryshme. Njëri prej tyre duhet të jetë Referent Kombëtar. Çdo konkurrent ka 13 minuta për të qëndruar në dhomën e garimit. Pas përfundimit të kësaj periudhe, përpjekja do të anulohet dhe konkurrenti do të marrë rezultatin që arriti deri në atë moment. Tastiera duhet të jetë e përshtatshme me standardin amerikan (QWERTY). NUK lejohet të përdoren kufje dhe tastierë të personale. Kompjuteri duhet të konfigurohet nga referentët (**Shiko shtojcën H**). Konkurrentët bëjnë dy përpjekje për të marrë 50 thirrje të prodhuara nga programi dhe përpjekja më e mirë do të merret si hyrja e konkurrentëve. Konkurrentët do të konkurrojnë me emrat e tyre ose me shenjat e thirrjes radioamatoriale personale të tyre. Konkurrentët kanë të drejtë të parapërgatiten, d.m.th. të bëjnë të gjitha rregullimet e mundshme dhe një provë të vetme. Koha për këto parapërgatitje është kufizuar në dy minuta duke filluar me hyrjen nga dera. Nëse referenti deklaron se koha e përgatitjes/pushimit ka mbaruar, konkurrenti duhet të fillojë menjëherë garimin. Para se të fillojë me garën e parë, ai/ajo duhet të nënshkruajë dokumentin që gjithçka funksionon si duhet. Midis përpjekjes së parë dhe të dytë lejohet një pushim maksimal prej një minute. Konkurrentët kanë të drejtë të zgjedhin shpejtësinë fillestare para se të fillojnë garën. Konkurrentët me rezultatet më të mira në Garën e Marrjes së Shenjave të Thirrjeve të Radioamatorëve i jepet një rezultat prej 100 pikësh. Konkurrentët e tjerë vlerësohen në mënyrë proporcionale si në shembullin vijues. Rekomandohet që gjatë Garës së Marrjes së Shenjave të Thirrjeve të Radioamatorëve, konkurrentët të mund monitorohen edhe nga jashtë në mënyrë që publiku të mund të ndjekë garën.

D2.3.2 GARA E SIMULIMIT TË CONTEST (Morse Runner)

Kjo garë zhvillohet në kompjutera IBM-kompatibël në prani të dy Anëtarëve të Jurisë që janë nga vende të ndryshme dhe njëri prej tyre duhet të jetë Referent Kombëtar. Konkurrentët lejohen ta përsërisnin dy herë këtë garë. Secila nga përpjekjet është e kufizuar me 10 minuta. Konkurrentët kanë 25 minuta kohë për të qëndruar në dhomën e garimit. Pas përfundimit të kësaj periudhe, garimi do të ndalet dhe rezultati më i mirë do të merret si përlllogaritje bazë për konkurrentët. Të gjithë konkurrentët nga një kategori do të konkurrojnë në të njëjtën kohë. Nëse një konkurrent bën zhurmë të qëllimshme duke shqetësuar e penguar sadopak konkurrentët e tjerë, ai do të diskualifikohet dhe nuk do t'i jepen pikë për atë garë. Tastiera duhet të jetë e përshtatshme me standardin amerikan (QWERTY). NUK lejohet të përdoren kufje dhe tastierë personale. Konkurrentët do të konkurrojnë me emrat e tyre ose shenjat e thirrjes radioamatoriale personale dhe kanë të drejtë të parapërgatiten për garën e tyre, d.m.th. të bëjnë të gjitha rregullimet e mundshme dhe një provë të vetme. Koha për këto parapërgatitje dhe provën është kufizuar në tre minuta duke filluar me hyrjen në dhomë. Para se të fillojë garën, ai/ajo duhet të nënshkruajë dokumentin që gjithçka funksionon siç duhet. Nëse referenti deklaron se koha e përgatitjes/pushimit ka mbaruar, konkurrenti duhet të fillojë menjëherë garën. Programi i garës do të jetë sipas **Shtojcës I**. Konkurrentëve me numrin më të lartë të pikëve në Morse Runner në secilën kategori i jepen 100



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

pikë dhe pjesëmarrësit e tjerë vlerësohen në mënyrë proporcionale më të ulët. Rekomandohet që konkurrentët të mund monitorohen edhe nga jashtë në mënyrë që publiku të mund të ndjekë garën.

D2.3.3 Konkurrentët që nuk arrijnë të shfaqen në ndonjë garë, mund t'u jepet një mundësi tjetër për të bërë garën vetëm në rast se anëtarët e jurisë përcaktojnë se ka pasur një arsye të justifikueshme për mungesën e konkurrentëve në garë.

E – KLASIFIKIMET DHE VLERËSIMET

E1 Vlerësimet Individuale

Në garat individuale për secilin ekip, vetëm një konkurrent për secilën kategori, i cili ka rezultatin më të mirë në garën përkatëse, do të listohet zyrtarisht, por në lidhje me rezultatet totale (shuma e katër garave) dy konkurrentët më të mirë nga një ekip do të listohen zyrtarisht. Titulli "Kampion Individual" do të jepet veçmas për secilën nga KATËR garat (a, b, c, d) në secilën nga nëntë kategoritë për konkurrentin me rezultatin më të lartë, si për femra ashtu edhe për meshkuj, të llogaritur si më poshtë:

- Gara MARRJE (RX)** - shuma e pikëve të fituara në tre garat e marrjes.
- Gara TRANSMETIM (TX)** - shuma e pikëve të fituara në tre garat e transmetimit.
- Gara e Marrjes së Shenjave të Thirrjeve të Radioamatorëve RUFZ-XP (RPT1)** - rezultati më i mirë i fituar nga të dyja përpjekjet.
- Gara e Simulimit të Contest Morse Runner (RPT2)** - rezultati më i mirë i fituar nga të dyja përpjekjet.
- Rezultati total** - shuma e KATËR rezultateve a), b), c) dhe d) si më sipër.

Në rast barazimi të pikëve të dy ose më shumë konkurrentëve në ndonjë nga garat (RX, TX, RPT1 ose RPT2), ose në rezultatin përfundimtar (RX+TX+RPT1+RPT2), klasifikimi duhet të bëhet sipas prioritetit të ushtrimeve të veçanta që përbëjnë garën:

- Gara MARRJE: 1-i përzier, 2-figura, 3-shkronja;
- Gara TRANSMETIM: 1-i përzier, 2-figura, 3-shkronja;
- Gara e Marrjes së Shenjave të Thirrjeve të Radioamatorëve RUFZ-XP (RPT1): shuma e dy përpjekjeve;
- Gara e Simulimit të Contest Morse Runner (RPT2): shuma e dy përpjekjeve;
- Rezultati total përfundimtar (RX+TX+RPT1+RPT2): 1-renditja e përgjithshme, 2-TX, 3-RX, 4-RPT1, 5-RPT2;

Në rast se edhe kontrolli i prioritetit nuk mund të përcaktojë klasifikimin, konkurrentët vendosen në të njëjtat vende relative dhe vendi tjetër/vendet tjera relative do të humbasin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tiranë, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

Në bazë të rezulttit total përfundimtar, titulli “KAMPION I PËRGJITHSHËM - KATEGORIA MESHKUJ” do t’i jepet fituesit të të gjitha kategorive për meshkuj (vetëm një certifikatë) dhe “KAMPION I PËRGJITHSHËM - KATEGORIA FEMËR ” do t’i jepet fitueses të të gjitha kategorive femër (vetëm një certifikatë). Për këto tituj, pikët do të rillogariten për të gjithë konkurrentët meshkuj apo femra sikur ata të konkurronin në të njëjtën kategori në lidhje me rezultatet më të mira të përgjithshme të të gjitha garave.

E2 Rezultatet Ekipore

Për të përcaktuar renditjen për një ekip të veçantë në kampionat, përdoret përlogaritësja e shumës së pikëve të fituara nga maksimumi 9 ANËTARË TË EKIPIT (pra vetëm një për çdo kategori). Kur një ekip ka tre konkurrentë në një kategori, vetëm pikët totale të konkurrentit/es me rezultatin më të lartë do të përlogariten për totalin e ekipit dhe ekipi me numrin më të lartë të pikëve do të marrë vendin e parë në kampionat. Pavarësisht nga numri i kategorive të përfaqësuara për një ekip të veçantë, klasifikimi ekipor do të përlogaritet vetëm si më sipër. Nëse rezultatet për dy ose më shumë ekipe janë të barabarta, vendin më të lartë do ta marrë ekipi me rezultatin më të mirë që ka dhe SHUMËN MË TË ULET TË VENDEVE individuale të fituara nga anëtarët konkurrentë të tij.

E3 Titujt dhe Çmimet

E3.1 Konkurrentët që fitojnë vendet e para në kategoritë e tyre, siç përcaktohet në paragrafin **E1** të këtyre Rregullave, do të fitojnë titullin e KAMPION KOMBËTAR ose KAMPION RAJONAL, sipas rastit dhe do të vlerësohen e dekorohen me Medalje Ari dhe Certifikata.

E3.2 Konkurrentët që fitojnë vendet e dyta dhe të treta në kategoritë e tyre, siç llogaritet në paragrafin **E1** të këtyre Rregullave, do të vlerësohen e dekorohen me Medalje Argjendi dhe Bronzi përkatësisht dhe Certifikata. Konkurrentët që fitojnë vendet e 4-të, 5-të dhe 6-të do të vlerësohen vetëm me Certifikata.

E3.3 Të gjitha çmimet (Medalje, Kupa dhe Certifikata) të përshkruara në këto Rregulla do të financohen nga Shoqëria Organizatore.

E3.4 Ekipi që fiton vendin e parë, siç përcaktohet në paragrafin **E2** të këtyre Rregullave, do të fitojë titullin e EKIPIT KAMPION ose EKIP KAMPION RAJONAL, sipas rastit. Ky ekip do të vlerësohet dhe dekorohet me një Kupë dhe një Certifikatë dhe të gjithë anëtarët e ekipit (maksimumi 28 persona përfshirë trajnerin e ekipit) do të vlerësohen e dekorohen me Medalje Ari dhe Certifikata.

E3.5 Ekipet dhe të gjithë anëtarët e ekipeve siç përshkruhet në **E3.4** që fitojnë vendet e dyta dhe të treta, siç përcaktohet në paragrafin **E2**, do të vlerësohen e dekorohen me Medalje Argjendi dhe Bronzi përkatësisht si dhe me Certifikata. Ekipet që fitojnë vendet e 4-të, 5-të dhe 6-të do të dekorohen vetëm me Certifikata.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

F - ÇËSHTJE QË NUK MBULOHEN NGA KËTO RREGULLA

F1 Të gjitha çështjet që lidhen me Garat dhe Kampionatet e “Telegrafisë me Shpejtësi të Lartë” të FSHR që nuk janë përfshirë ose specifikuar në këto Rregulla, duhet të referohen dhe të shqyrtohen nga Grupi i Punës i HST Rajonal përkatës. Gjatë zhvillimit të Kampionatit HST, çështje të tilla duhet ose mund të referohen dhe të shqyrtohen gjithashtu edhe nga Juria Kombëtare e Kampionatit.

F2 Ndryshimet në këto Rregulla mund të bëhen vetëm nga Asambleja e Përgjithshme dhe Kryetarët e Klubeve të FSHR ose, në periudhën midis Asambleve, nga Komiteti Ekzekutiv i FSHR.

SHTOJCË

Ndryshimet në **SHTOJCË** mund të bëhen nga Asambleja e Përgjithshme, nga Kryetarët e Klubeve, nga Komiteti Ekzekutiv i FSHR ose Grupi i Punës i HST nëse shumica e anëtarëve votojnë pro.

A1. Programi i garave që do të përdoret gjatë kampionatit është:

- a) **Gara MARRJE:** Programi "ZEUS" version 1.7.7 i kompiluar nga Slawomir Kowalski dhe Adam Mucha
- b) **Garat e praktikës:**
 - 1) programi "**RUFZ-XP**" version 1.1.1 i kompiluar nga Mathias Kolpe DL4MM dhe Alessandro Vitiello IV3XYM
 - 2) programi "**Morse Runner**" version 1.67 i kompiluar nga Alex Shovkopyas VE3NEA, modifikuar nga Toni Stanojoski

A2. Programi që do të përdoret gjatë kampionatit për kontrollin e teksteve është:

- c) **Gara MARRJE:** programi "ZEUS" version 1.7.7 i kompiluar nga Slawomir Kowalski dhe Adam Mucha
- d) **Gara TRANSMETIM:** programi “HST2006” v1.23 i kompiluar nga Andrei Bindasov EU7KI

A3. SHPEJTËSIA FILLESTARE PËR GARAT E MARRJES

Shpejtësia për marrjen dhe transmetimin do të matet në shenja REALE. Shpejtësia fillestare për marrjen është 80 shenja (shkronja, numra, të përziera) në minutë (50 shenja për kategoritë A dhe B).

B. REKORDI KOMBËTAR ose RAJONAL

Rekordi kombëtar ose rajonal mund të bëhet vetëm gjatë kampionateve zyrtare të mbajtura nga një shoqëri kombëtare ose rajonale përkatësisht, e cila është anëtare e FSHR ose në Kampionatet HST të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

FSHR-së. Për të miratuar arritjen e rekordit kombëtar gjatë kampionateve kombëtare të hapura, duhet që Juria Kombëtare të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Kryetari i Jurisë të jetë referent Kombëtar i miratuar gjatë kampionateve të FSHR-së
- Të paktën dy referentë kombëtarë të jenë miratuar gjatë kampionatit të FSHR-së, të cilët nuk janë anëtarë të shoqërisë pritëse dhe të dy të jenë nga vende të ndryshme. Në rast se njëri prej tyre është Kryetar i Jurisë Kombëtare, nuk ka nevojë për një referent të tretë Kombëtar.

C. SINJALET PROCEDURALE TË MARRJES

- Grupet prej 5 shkronjash OOOO (Oscar), shpejtësia e transmetimit, VVV =
- Grupet prej 5 Numrash 0000 (Zero), shpejtësia e transmetimit, VVV = (Shënim: shifra 0 (Zero) duhet të dërgohet si PËSË VIJA)
- Grupet prej 5 karakteresh të përziera 0000 (Zero), shpejtësia e transmetimit, VVV =

Të gjitha mesazhet e dërguara në një garë marrjeje duhet të përfundojnë me AR.

SHEMBULL:

00000 100 VVV = TEKSTI I MESAZHIT AR 60 SEKONDA PUSHIM 00000 110 VVV = TEKSTI I MESAZHIT AR 60 SEKONDA PUSHIM 00000 120 VVV = TEKSTI I MESAZHIT AR

D. LLOJET E GABIMEVE GJATË GARËS SË MARRJES

Gabimet e mëposhtme klasifikohen si gabime marrjeje:

- Marrja/regjistrimi i gabuar i një shenje (karakteri) të dërguar. (Shenjë e gabuar.)
- Mos-marrja/mos-regjistrimi i një shenje të dërguar. (Shenjë e humbur.) Nuk ka nevojë të tregohet pozicioni i shenjës së humbur.
- Marrja/regjistrimi i një shenje të pa dërguar. (Shenjë shtesë.)
- Marrja/regjistrimi në rend të gabuar i dy karaktereve të dërguar. (Invertim i shenjave ngjitur.)
- Marrja/regjistrimi i një shenje jo konvencionale, simboli ose shenjës së palexueshme.

SHEMBULL:

Mesazhi i dërguar: 12345 67890 34789 25371 ...

Mesazhi i marrë/regjistruar: 12245 678390 37489 531 ...

Gabimet:

Grupi 1 - një gabim, shih a) më sipër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

- Grupi 2 - një gabim, shih c) më sipër.
- Grupi 3 - dy gabime, shih d) më sipër.
- Grupi 4 - dy gabime, shih b) më sipër.

E. SHEMBULL MESAZHI PËR GARËN E TRANSMETIMIT

ABVGD FYVAK NGQZH IMSTL JNUCE

ADRG O MAKUV TLQNY JOAIZ UZGIT

ose

1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 1 3 6 0 7 6 3 2 9 7 3 6 5 2

2 3 4 8 9 8 3 6 4 1 7 8 0 3 2 2 3 7 2 5 8 9 3 4 5

ose

DX?/1 HG4B/ X.6B= ?=MBG 43A/=

,7L.8 Z?43Q OOL/. A,=X3 DF48/

F. VLERËSIMI I KOHËS, SHPEJTËSISË DHE REZULTATIT PËR GARAT E TRANSMETIMIT

Kur konkurrentët të cilët tejkalojnë numrin e lejuar prej tre gabimeve të pa korrigjuara, mesazhet e tyre të transmetuara do të vlerësohen vetëm deri në pikën ku ndodh gabimi i katërt i pa korrigjuar.

SHEMBULL: Një konkurrent transmeton mesazhin me një shpejtësi prej 210 shenjash në minutë, por bën gabimin e tij të katërt të pa korrigjuar në sekondën e 47-të. Deri në sekondën e 47-të ai kishte transmetuar 170 shenja, kështu që shpejtësia e tij përcaktohet si 170 shenja në minutë me 3 gabime të pa korrigjuara. Numri i gabimeve rezulton në një koeficient zvogëluar prej 0.85 siç përcaktohet në tabelën më poshtë (duke supozuar se nuk ka asnjë zbritje për dhënie jo-uniforme).

Gabimet e mëposhtme klasifikohen si gabime transmetimi:

- a) Transmetimi i gabuar i shenjës
- b) Transmetimi i një shenje (karakteri) që nuk është në tekstin e transmetimit.
- c) Lënia pas dore e një shenje që është në tekst.
- d) Transmetimi i dy karaktereve në rend të gabuar. (Invertim i shenjave ngjitur.)
- e) Transmetimi i një shenje gabimi në mënyrë të gabuar.

SHEMBULL:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

Mesazhi për transmetim: 12345 67890 34789 25371 ...

Mesazhi i transmetuar: 12245 678390 37489 531 ...

Gabimet:

Grupi 1 - një gabim, shih a) më sipër.

Grupi 2 - një gabim, shih b) më sipër.

Grupi 3 - dy gabime, shih d) më sipër.

Grupi 4 - dy gabime, shih c) më sipër.

Për të korigjuar një gabim, një konkurrent duhet të transmetojë SINJALIN E GABIMIT, dmth. një seri prej të paktën gjashtë pikash, dhe pastaj të ri-transmetojë të gjithë grupin në të cilin ka ndodhur gabimi. Pas SINJALIT TË GABIMIT, konkurrenti mund të kthehet vetëm një grup në rast se gabimi ka qenë në grupin e mëparshëm. Nëse një konkurrent gabimisht transmeton të njëjtin grup ose të gjithë rreshtin dy herë, kjo numërohet si gabim dhe koha vazhdon të numërohet pa ndërprerje

G. KOEFICIENTI I PËRLLOGARITJES SË PIKËVE PËR GARAT E TRANSMETIMIT

Koeficienti i përlogaritjes më i lartë i mundshëm është 1.00.

Gabimet do të rezultojnë në rritjen e koeficientit të përlogaritjes së pikëve me:

- 0.05 për çdo gabim (maksimumi $3 \times 0.05 = 0.15$)
- 0.01 deri 0.05 në hapa prej 0.01 për dhënie jo-uniforme

Kjo prodhon një penalizim maksimal prej 0.2 ($0.15 + 0.05$). d.m.th. që koeficienti zvogëluar mund të ndryshojë nga 0.8 deri në 1.00.

Për korigjimet nuk duhet të ketë ASNJË lloj penalizimi.

H. KONFIGURIMET për "Garën e Marrjes së Shenjave të Thirrjeve të Radioamatorëve" RUFZ XP v1.1.1

Programi RUFZ XP duhet të konfigurohet si në këtë mënyrë: RUFZ → HST mode

I. KONFIGURIMET për "Morse runner v1.67"

Programi duhet të përdoret me konfigurimin e garës HST. Menuja kryesore duhet të vendoset si më poshtë:

[System]

Call=optional

Buf Size=3

Name=optional

[Station]

Pitch=optional



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

Band Width=10
Wpm=optional
QSK=0
Self Mon Volume= 0
Save Wav=0
[Band]
Activity=4
QRN=0

QRM=0
QSB=0
Flutter=0
Lids=0
[Contest]
Duration=10
Hi Score=0
Competition Duration=10

Të gjitha karakteristikat duhet të vendosen dhe të kontrollohen në skedarin e konfigurimit nga juria përpara garës.

J. REFERENTËT KOMBËTARË

Çdo Shoqëri ose Klub Sportiv mund autorizohet të caktojë një kandidat ose kandidatë për të qenë Referent Kombëtar. Kushtet për këtë janë si më poshtë:

Për Jurinë e Transmetimit:

Kandidati duhet të jetë në gjendje të marrë numrat mbi shpejtësinë prej 150 shenjash REALE dhe të njohë shumë mirë të gjitha Rregullat.

Për garat e praktikës:

Kandidati duhet të njohë shumë mirë të gjitha Rregullat dhe të ketë aftësi shumë të mira në programet kompjuterike për garat e praktikës: Garën e Marrjes së Shenjave të Thirrjeve të Radioamatorëve RUFZXP dhe Garën e Simulimit të Contestit Morse Runner.

Një Referent Kombëtar mund të emërohet nga Kryetari i Grupit të Punës dhe të miratohet pastaj nga Grupi i Punës i Kampionatit "Telegrafi – Shpejtësi e Larë".



PRESIDENTI i FSHR

Florian Gjonej